

FAKULTETI I DREJTËSISË**RREGULLORE
E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR
NË E DREJTË BIZNESI****KREU I
PARIMET E PËRGJITHSHME****Neni 1
Baza ligjore**

Rregullorja e programit të studimit Bachelor në E Drejtë Biznesi mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 datë 22. 07. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së, Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

**Neni 2
Objekti**

Kjo rregullore përcakton organizimin e programit të studimit Bachelor në E Drejtë Biznesi, duke respektuar legjislacionin në fuqi, lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

**KREU II
ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR****Neni 3
Qëllimi dhe objektivat**

Qëllimi i këtij programi studimi është të përgatisë juristë të cilët janë specialistë për çështje juridike tregtare si dhe ato juridike administrative të aftë për të punuar në shoqëri tregtare publike dhe/ose private, por edhe në studio të ndryshme avokatie që i shërbejnë biznesit.

Objektivat e programit Bachelor janë:

- Studenti të pajiset me njohuritë themelore dhe të avancuara të shkencës juridike, dhe të mund të përvetësojë më në gjerësi dhe thellësi njohuritë në të drejtën civile, administrative dhe tregtare që lidhen e janë më pranë sipërmarrjes. Njohuritë e fituara nga studenti përfaqësojnë eksperiencat e konsoliduara të fushës dhe të përshtatura edhe për kushtet e ekonomisë shqiptare.
- Të pajisë studentin me njohuri të avancuara mbi legjislacionin shqiptar por edhe me njohuritë e nevojshme nga legjislacioni evropian për çështjet tregtare dhe administrative.

- Studenti të jete i afte të zgjidhë probleme praktike e komplekse që hasin shoqërite tregtare dhe studiot ligjore, si dhe institucionet publike, gjatë viteve të studimit nëpërmjet kryerjes së praktikave në to dhe/ose punësimit.
- Të mundësojë vazhdimin me sukses të studimeve master të studentit, në Shqipëri ose jashtë vendit, dhe gjithashtu të jetë konkures në tregun e punës brenda vendit dhe në vende të tjera, në qoftë se ai/ajo dëshiron të punësohet jashtë vendit.
- Studenti të jetë kompetent e të marrë përsipër përgjegjësi për të zgjidhur situata të paparashikuara në punë si në sektorin publik, por mbi të gjitha në atë privat, ku njohuritë e fituara lejojnë që ai të përshtatet lehtë në ambjentet e biznesit.
- TBU synon që përpara mbarimit të vitit të tretë studentët më cilësorë të jenë punësuar në pozicion pune ndihmës jurist në zyra juridike ose në pozicione pune në banka, kompani apo zyra publike ku trajtohen çështje juridike.

Neni 4

Programi i Studimit

- a) Programi i Studimit Bachelor në E Drejtë Biznesi, është program i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me 180 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë.
- b) Programi i studimit është parashikuar të realizohet në të paktën 4,500 orë, nga të cilat rreth 1,560 orë janë orë studimi në auditor dhe rreth 2,940 orë janë orë studimi individual.
- c) Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Përgjatë çdo viti akademik, studentit kryen praktikë profesionale ose punë në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 4 javë.
- d) Koha e fillimit, mbarimit, sezonet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik e të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik.

Neni 5

Struktura e programit të studimit

Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 180 kredite, nga të cilat 31 ECTS në kategorinë(A); 97 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 27 ECTS në kategorinë e lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese si edhe lëndët me zgjedhje (C);19 ECTS në kategorinë e lëndëve plotësuese (D); 6 ECTS detyrime përmbyllëse (E).

Në tabelën vijuese jepet struktura e veprimtarive formuese e programit të studimit.

PROGRAMI “BACHELOR E DREJTË BIZNESI”

Veprimtaritë Formuese Programi Bachelor në E Drejtë Biznesi				
Kategoria	Tipi i komponentit mesimor	Lendet		ECTS
A	Lende Baze (15-20%) (27-36 ECTS)*	1	E Drejta Romake	6
		2	E Drejta Private	5
		3	Filozofia e Shtetit dhe e Së Drejtës (I+II)	10
		4	Komunikim Profesional dhe Akademik	10
		5	Të Drejtat e Njeriut	5
B	Lende Karakterizuese (50-55%) (90-99 ECTS)			
	Lendet karakterizuese te Programit EDB**	1	E Drejta Publike	6
		2	E Drejta Kushtetuese	6
		3	E Drejta Administrative (I+II)	12
		4	Gjykimi Administrativ	6
		5	E Drejta Civile(I+II+III)	18
		6	Procedurë Civile(I+II)	12
		7	E Drejta Penale (I+II)	10
		8	Procedurë Penale (I+II)	10
		9	E Drejta e Shoqerive Tregtare	6
		10	Anglishtja e Biznesit	5
		11	Pronësi Intelektuale	6
		12	E Drejta Fiskale	6
		13	E Drejta e Punes	6
		14	E Drejte Biznesi	6
15	E Drejta Tregtare Europiane	6		
			Total ECTS	97
C	Lende Nderdisiplinore/Integruese, profilizuese dhe me zgjedhje*** (12-15%) (21.6 -27 ECTS)	1	Sjellje Organizative	5
		2	Hyrje në Biznes	5
		3	Shkrim dhe Arsyetim Ligjor	5
		4	E Drejta e Bashkimit European (Lz)	6
		5	Hyrje në Logjiken Formale (Lz)	6
		6	Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare (Lz)	6
		7	Avokatia Praktike e Biznesit (Lz)	6
		8	Pergjegjesia Civile dhe Penale e Biznesit (Lz)	6
		9	E Drejta Administrative Europiane (Lz)	6
		10	E Drejta Europiane Private (Lz)	6
		11	E Drejta Bankare (Lz)	6
		12	E Drejta e Konkurrencës dhe Antitrasti (Lz)	6
		13	E Drejta e Konsumatorit dhe Siguria e Produkteve (Lz)	6

		14	E Drejta Familjare (Lz)	6
			Total ECTS	27
D	Lende Plotesuese (10-15%) (18 -27 ECTS)	1	Anglishtja e Pergjithshme	4
		3	Praktika profesionale/seminar special	15
			Total ECTS	19
E	Detyrime Permbydhese (3-5%) (5.4 - 9 ECTS)		Teme Diplome/Provimi i Pergjithshem Perfundimtar	6
Gjithsej 21 Lende		Bachelor e Drejte Biznesi		Total ECTS
				180
* Nga lendet e renditura ne kategorine e lendeve baze, per cdo vit akademik do te ofrohen vetem 4 prej tyre. Kjo percaktohet ne planet mesimore qe perгатiten cdo vit akademik, ku njesite baze pergjegjese per kete program studimi percaktojne lendet qe do te ofrohen				
** Nga lendet e renditura ne grupin prej renditjes 11 deri ne 15, per cdo vit akademik do te ofrohet vetem 1 prej tyre. Kjo percaktohet ne planet mesimore qe perгатiten cdo vit akademik, ku njesitre baze pergjegjese per kete program studimi percaktojne lenden qe do te ofrohet.				
*** Nga lendet e renditura ne grupin prej renditjes 4 deri ne 14 si lende me zgjedhje (Lz), studentet do te zgjedhin 2 prej tyre.				

Neni 6

Lëndët dhe veprimtaritë e tjera formuese

- a) Numri i veprimtarive formuese është 25 ku janë parashikuar 21 lende (dhe provime), 3 raporte praktike dhe tema e diplomës, ose provimi i pergjithshem përfundimtar.
- b) Lëndët janë ndarë në katër grupe kryesore: (A) lëndë baze - 4 lende: (B) lëndë karakterizuese të programit dhe të profilit-11 lëndë; (C) lëndë ndërdisiplinore/integruese -5 lëndë; (D) lëndë plotesuese – 1 lëndë dhe praktika profesionale.

Neni 7

Plani mësimor

Plani mësimor indikativ, që pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disipline dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, për këtë program studimi është dhënë në Aneksin A .

Neni 8

Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore

Planet mësimore të paraqitura në nenin 7 më sipër, mund të përshtaten cdo vit akademik në përputhje me propozimet e njesive bazë dhe aprovohen nga Rektori. Gjithashtu keto plane mësimore përshtaten edhe në përputhje me nenet 6,7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet Studimit dhe Procesin Mësimor.

Neni 9

Praktikat mësimore

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik bëhet sipas procedurave të percaktuara në Rregulloren për Programet Studimit dhe Procesin Mësimor dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

Neni 10

Kontrolli i dijes dhe sistemi i vleresimit

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vleresimit janë të percaktuara me detaje në nenet 14-23 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mesimor.

KREU III

PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E STUDIMIT

Neni 11

Kriteret dhe Proçedura e Pranimit të Studentëve

- a) Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në E Drejte Biznesi është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë te pakten nje diplomë të shkollës së mesme, shqiptarë ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentet me transferim.
- b) Përpara fillimit të rregjistrimeve të çdo viti akademik Njësitë Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit përcaktojnë edhe kriteret të veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

Neni 12

Afati i studimeve

- a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor në E Drejte Biznesi me kohë të plotë është 3 vite akademike.
- b) Në çdo rast studenti nuk mund të zgjase studimet përtej dyfishit të afatit zyrtar të programit të studimit përveç rasteve kur ai ka pezulluar studimet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet Studimit dhe Procesit Mesimor.

KREU IV

VLERËSIMI ME KREDITE

Neni 13

Kreditet dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi.

Në tabelën më poshtë është dhënë ndarja në orë në auditor dhe orë pune individuale, që është përdorur si rregull për cdo një kredit për këtë program studimi.

1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total
Orë në auditor = rreth 10 orë
Orë punë individuale = rreth 15 orë
(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshëm, Provimi final)

KREU V VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

Neni 14 Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë

- a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor në E Drejte Biznesi” vlerësohen çdo vit në përfundim të programit nga Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë
- b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.
- c) Grupi i vlerësimit të brendshëm mbledh të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

KREUVI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

- a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigojohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi Bachelor në E Drejtë Biznesi.
- b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit të Drejtësisë.

ANEKSI A
1 - PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT BACHELOR E DREJTË BIZNESI

PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT BACHELOR E DREJTË BIZNESI											
SEMESTRI	Nr.	Lendet	Kategoria e vep.formuese	ECTS	Leksione	Seminare	Jave gjithsej	Gjithsej Leksione	Gjithsej Seminare	Total ore ne auditor	Ore pune individuale
SEMESTRI I	1	E DREJTA ROMAKE	A	6	3	1	15	45	15	60	90
	2	E DREJTA PUBLIKE	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	3	HYRJE NE BIZNES	C	5	2	1	15	30	15	45	80
	4	E DREJTA PRIVATE	A	5	2	1	15	30	15	45	80
	5	FILOZOFOIA E SHETIT DHE E SE DREJTES I	A	5	2	1	15	30	15	45	80
Total semestri I				27	12	5	15	180	75	255	420
SEMESTRI II	6	ANGLISHTJA E PERGJITHSHME	D	4	2	1	15	30	15	45	55
	7	FILOZOFOIA E SHETIT DHE E SE DREJTES II	A	5	2	1	15	30	15	45	80
	8	KOMUNIKIM PROFESIONAL DHE AKADEMIK	A	10	3	3	15	45	45	90	160
	9	E DREJTA KUSHTETUESE	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	10	ANGLISHTJA E BIZNESIT	B	5	2	1	15	30	15	45	80
11	Praktika profesionale/seminar special	D	3								75
Total Semestri II				33	12	7	15	180	105	285	540
Total Viti I				60			30	360	180	540	960
SEMESTRI III	1	E DREJTA ADMINISTRATIVE I	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	2	SJELLJE ORGANIZATIVE	C	5	2	1	15	30	15	45	80
	3	E Drejta Penale I	B	5	2	1	15	30	15	45	80
	4	Procedura Penale I	B	5	2	1	15	30	15	45	80
	5	E DREJTA CIVILE I	B	6	3	1	15	45	15	60	90
Total semestri III				27	12	5	15	180	75	255	420
SEMESTRI IV	6	GJYKIMI ADMINISTRATIV	B	6	3	1	15	45	15	60	90
		E DREJTA PENALE II	B	5	3	1	15	45	15	60	65
		E drejta Administrative II	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	9	PROCEDURE PENALE II	B	5	3	1	15	45	15	60	65
	10	E DREJTA CIVILE II	B	6	3	1	15	45	15	60	90
11	Praktika profesionale/seminar special	D	5								125
Total semestri IV				33	15	5	15	225	75	300	525
Total Viti II				60			30	405	150	555	945

SEMESTRI V	1	PROCEDURE CIVILE I	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	2	SHKRIM DHE ARSYETIM LIGJOR	C	5	2	1	15	30	15	45	80
	3	E DREJTE CIVILE III	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	4	E DREJTA SHOQERIVE TREGETARE	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	5	LENDE KARAKTERIZUESE*	B	6	3	1	15	45	15	60	90
Total semestri V				29	14	5	15	210	75	285	440
	6	Procedura Civile II	B	6	3	1	15	45	15	60	90
	7	LENDE ME ZGJEDHJE**	C	6	3	1	15	45	15	60	90
	8	LENDE ME ZGJEDHJE**	C	6	3	1	15	45	15	60	90
	10	Praktika profesionale/seminar special	D	7							175
	11	Diploma/Provimi i Pergjithshem Perfundimtar	E	6							150
Total semestri VI				31	9	3	45	135	45	180	595
Total Viti III				60			60	345	120	465	1035
TOTAL Programi Bachelor E Drejte Biznesi				180			120	1110	450	1560	2940
<p>* Nga lëndet karakterizuese të renditura në grupin prej renditjes 11 deri në 15 që janë paraqitur në Tabelën e Veprimtarive Formuese të Programit Bachelor E Drejtë Biznesi, për çdo vit akademik do të ofrohet vetem 1 prej tyre.</p>											
<p>** Nga lëndët e kategorisë ndërdisiplinore/integruese të renditura në grupin prej renditjes 4 deri në 14 që janë paraqitur në Tabelën e Veprimtarive Formuese të Programit Bachelor E Drejtë Biznesi, si lëndë me zgjedhje (LZ), studentet do të zgjedhin 1 prej tyre.</p>											